



Në pajtim me nenin 7, paragrafi 2 i Rregullores së punës të Këshillit drejtues të Fondacionit Albiz, duke u bazuar në nenin 12 të Rregullores për Punën e Komisionit për veprimtarinë botuese, me qëllim të promovimit dhe përkrahjes së librit, Fondacioni për zhvillim të arsimit dhe kulturës Albiz, shpall:

KONKURS

(PËR VEPRIMTARINË BOTUESE PËR VITIN 2018)

Mbështetja financiare ju dedikohet fushave në vijim :

- Veprat nga krijimtaria letrare, gjuhësore, kulturore dhe historike
- Përkthime të veprave kulmore nga gjuhë të huaja
- Studime Ekonomike, Sociale dhe Humane
- Hulumtime nga sfera Teknologjisë së Komunikimit dhe Informacionit

Në konkursin për veprimtarinë botuese për vitin 2018 do të përfshin dy kategori konkurrimi:

- I. Konkurrin për botim të plotë**
- II. Konkurrin për përkrahje të pjesshme financiare të botimeve**

I. Konkurrin për botim të plotë

Në kategorinë e konkurrimit për botim të plotë, do të kenë të drejtë të aplikojnë të gjithë autorët me tekstet e tyre autoriale që do të konkurrojnë për mbështetje të tërësishme të veprave të tyre ku si botues do të paraqitet Fondacioni Albiz.

Kriteret (kushtet) dhe procedurat :

- Të drejtë aplikimi kanë autorë, persona fizikë për tekste autoriale;
- Një autor ka të drejtë të aplikojë vetëm me një libër apo punim;
- Do të merren në konsideratë për botim vetëm libra ose punime që janë të gatshme për botim (**të lekturuara dhe redaktuara**);
- Të gjitha tekstet të jenë origjinale;
- Do të financohen vetëm përkthimet e botimeve që shquhen për cilësi të lartë shkencore dhe që bëjnë të mundur një përmirësim domethënës ose një përparim të më tejshëm të kërkimit në fushën përkatëse;
- Dokumentet duhet të dorëzohen personalisht nga vetë kandidati (përndryshe janë të pavlefshme);
- Dokumentet duhet të jenë të futura në zarf;
- Ç'do person i cili do të konkurrojë duhet që të marrë dëshmi (numër të dosjes) se i ka dorëzuar dokumentet;
- Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen prapë, mbetet në arkivin e Fondacionit;
- Dokumentet që janë të pakompletuara dhe që dërgohen me vonesë, përkatësisht nuk i kanë respektuar afatet kohore të konkursit, nuk do të pranohen;
- Rezultatet do të shpallen me numra të dosjes;

Në këtë konkurs nuk mund të përkrahen:

- *Vepra tashmë të botuara*
- *Tekstet shkollore*
- *Publikimet komerciale*
- *Publikime për festa apo përkujtime*

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Aplikacioni i plotësuar me të dhënat në detaje të aplikuesit
- Kopje të dorëshkrimit të gatshme për botim në CD (Punimi të jetë në Word)
- Mendimi i dy recensentëve profesional nga fusha përkatëse

**Për veprat e përzgjedhura në këtë konkurrim të drejtën autoriale për botim e mban Fondacioni Albiz.*

II. Konkurrin për përkrahje të pjesshme financiare të botimeve

Në kategorinë e konkurrimit, do të kenë të drejtë të aplikojnë të gjithë autorët me tekstet e tyre autorial të cilët kanë nevojë për përkrahje të pjesshme të botimeve të tyre.

Kriteret (kushtet) dhe procedurat :

- Të drejtë aplikimi kanë autorë, persona fizikë për tekste autoriale;
- Një autor ka të drejtë të aplikojë vetëm me një libër apo punim;
- Do të merren në konsideratë për botim vetëm libra ose punime që janë të gatshme për botim (**të lekturuara dhe redaktuara**);
- Të gjitha tekstet të jenë origjinale;
- Do të financohen vetëm përkthimet e botimeve që shquhen për cilësi të lartë shkencore dhe që bëjnë të mundur një përmirësim domethënës ose një përparim të më tejshëm të kërkimit në fushën përkatëse;
- Dokumentet duhet të dorëzohen personalisht nga vetë kandidati (përndryshe janë të pavlefshme);
- Dokument që dëshmon sigurimin e mjeteve tjera financiare;
- Dokumentet duhet të jenë të futura në zarf;
- Ç'do person i cili do të konkurrojë duhet që të marrë dëshmi (numër të dosjes) se i ka dorëzuar dokumentet;
- Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen prapë, mbetet në arkivin e Fondacionit;
- Dokumentet që janë të pakompletuara dhe që dërgohen me vonesë, përkatësisht nuk i kanë respektuar afatet kohore të konkursit, nuk do të pranohen;
- Rezultatet do të shpallen me numra të dosjes;

Në këtë konkurs nuk mund të përkrahen:

- *Vepra tashmë të botuara*
- *Tekstet shkollore,*
- *Publikimet komerciale;*
- *Publikime për festa apo përkujtime*

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Aplikacioni i plotësuar me të dhënat në detaje të aplikuesit
- Kopje të dorëshkrimit të gatshme për botim në CD
- Mendimi i dy recensentëve profesional nga fusha përkatëse
- Dokument që dëshmon sigurimin e mjeteve tjera financiare nga palë tjera

VENDI DHE AFATI PËR DORËZIMIN E DOKUMENTEVE

Aplikacioni me dokumentacionin e kërkuar dorëzohen, nga data **07.12.2017** deri më **28.02.2018** deri në ora 13:00 në zyrën e Fondacionit Albiz *Rr.20, nr.97 Saraj, 1000 Shkup*

Shpallja e rezultateve do të bëhet gjatë muajit Mars, pran zyrës së Fondacionit Albiz në web faqen zyrtare www.albiz.org.mk si dhe në www.facebook.com/albizfoundation.